REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

ZV/KRYETARI I K.K.T-së

Znj. EGLANTINA GJERMENI

MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-së Nr. 1, Datë 14/06/2016

AKPT

SHQIPËRIA 2030

PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

HARTA E SISTEMIT BUJQËSOR

# PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

## HARTA E SISTEMIT BUJQËSOR




### Parimet

Sistemi bujqësor mbështetet në 3 parime; Ruajtje, Konsolidim dhe Modernizim.

- *Ruajtje* e fondit të tokës bujqësore, do të thotë asnjë ndërtim i ri në tokën bujqësore që nuk është në përputhje me zhvillimin bujqësor.
- *Konsolidimi* i tokës bujqësore, do të aplikohet me qëllim rritjen e madhësisë së fermës bujqësore dhe eficientimin e saj.
- *Modernizimi* i sistemit bujqësor, do të arrihet nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së re për rritjen e produktivitetit të fermës bujqësore.

### Projektet strategjike përfshijnë:

Ngritjen dhe konsolidimin e 6 poleve bujqësore në Shkodër, Tiranë, Dibër, Lushnje, Korçë dhe Sarandë.

Këto pole në vetvete përfaqësojnë një sistem, i cili do të përbëhet nga:

a) Ngritja e qendrave kërkimore për zhvillimin e kulturave autentike bujqësore;

b) Ngritja e strukturave të përshtatshme për grumbullimin, përpunimin dhe paketimin e produkteve bujqësore të fermerëve vendas;

c) Krijimin e tregjeve lokale për promovimin dhe tregtimin e produkteve bio-organike.

d) Ruajtjen dhe promovimin e zonave të thella malore, pyjeve, foragjerëve si dhe të hapësirave të tjera të përshtatshme për kultivimin e bimëve aromatike;

e) Promovimin e lidhjeve për studim dhe zhvillim ndërmjet qendrave të inovacionit dhe të përpunimit të produkteve ushqimore.




### LEGJENDA

- Metropol
- Qendër primare
- Qendër sekondare
- Qendër terciare
- Qendër lokale e specializuar
- Qendër e transferimit të teknologjisë bujqësore / Fushë-Krujë, Lushnje, Vlorë, Korçë, Shkodër
- Pol bujqësor / Shkodër, Dibër, Tiranë, Lushnje, Korçë, Sarandë
- Toka me kultivim kompleks / tokë bujqësore
- Vreshtari
- Pemë frutore
- Ullishte
- Tokë pyjore
- Kufi bashkie
- Infrastrukturë rrugore
- Lumenj
- Vijë uji
- Digë (Grupi A)
- Digë (Grupi B)
- Digë (Grupi C)
- Port detar
- Pikë kufitare / ekzistuese
- Pikë kufitare / e propozuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

ZV/KRYETARI I K.K.T-së

Znj. EGLANTINA GJERMENI

MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-së Nr. 1, Datë 14/06/2016

AKPT SHQIPËRIA 2030

PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

HARTA E SISTEMIT UJOR

| DATA 14/06/2016 | SHKALLA 1:400000 | NR. I FLETËS U-04 | NR. I KOPJEVE 01/06 |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **GRUPI I PUNËS** | |
| Drejtore e Përgjithshme Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | Adelina Greca, Arkitekt/Planifikues Urban |
| Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, AKPT | Anisa Qorri, Arkitekt/Planifikues Urban |
| Specialist, AKPT | Eleana Berula, Arkitekt |
| Specialist, AKPT | Ismail Broli, Planifikues Urban dhe Rajonal |
| Specialist, AKPT | Mirzeta Kashnica, Planifikues Urban |
| Drejtore e Regjistrit të Integruar të Territorit, AKPT | Albana Koçollari, Arkitekt |
| Specialist, AKPT | Shpendi Balilaj, Planifikues Urban |
| Përgjegjës sektori, AKPT | Bledi Dimo, Inxhinier Mjedisi |
| Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve, AKPT | Deni Klosi, Arkitekt/Urbanist |
| **MBËSHTETI** | |
| Drejtoria e Politikave të Zhvillimit të Territorit, Ministria e Zhvillimit Urban | Nertil Jole, Drejtor |
| | Ledio Allkja, Përgjegjës sektori |

# PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR

## HARTA E SISTEMIT UJOR




### Parimet

- 0 % derdhje të ujërave të ndotura në trupat ujorë deri në 2030;
- Mbrojtje nga shfrytëzimi intensiv i inerteve të lumenjve;
- Mbrojtje nga efektet e vend-depozitimeve të mbetjeve urbane;
- Mbrojtje nga efektet e aktiviteteve bujqësore dhe industriale.

### Masa Strategjike

Në mbrojtje të sistemit ujor, PPK vendos:

- **Vijën Blu,** e cila ka për qëllim:

- mbrojtjen nga përdorimet e ndaluara të hapësirës së brezit bregdetar, të përcaktuar sipas legjislacionit sektorial për mbrojtjen e burimeve ujore;
- monitorimin e aktiviteteve për shfrytëzim ekonomik në hapësirën e brezit bregdetar;
- rigjenerimin e korridoreve natyrore që shoqërojnë rrjedhat lumore.

- Njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror të territorit që shtrihet nga vija bregdetare deri në kreshtën e brezit të parë kodrinor-malor.

- Marrjen në **mbrojtje** të pellgut ujëmbledhës të **Vjosës.**

Vjosa dallon nga të gjithë lumenjtë e tjerë në Ballkan për shkallën e lartë të ujëshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve që përshkon dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës. Mbrojtja do të realizohet duke aplikuar procesin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, me synimin që të përcaktohen zonat ekologjike për t'u shpallur në mbrojtje, duke ndjekur në mënyrë të harmonishme, parimet e mëposhtme:

1. *Barazi Sociale*: që të sigurohet qasje e barabartë për të gjithë përdoruesit (veçanërisht grupet e margjinalizuara dhe përdoruesit e varfër) për një sasi dhe cilësi të nevojshme të ujit, për të plotësuar nevojat dhe mirëqenien e tyre;
2. *Efikasitet Ekonomik*: që të sjellë përfitime për një numër sa më të madh përdoruesish;
3. *Qëndrueshmëri Ekologjike*: për të siguruar që ekosistemet ujore të shihen si përdorues më vete dhe ndarja e tyre të bëhet për të mbështetur funksionin e tyre natyror.

- Kërkesat për furnizim të sigurt të qendrave të banuara të lidhen ngushtë me kërkesat teknike të infrastrukturës së furnizimit me ujë.

Lidhur me këtë, në dokument paraqiten disa nga kriteret ligjore që duhen marrë në konsideratë kur hartohen planet territoriale për furnizim të sigurt me ujë të pijshëm;

- Të paraqesë risqet dhe të propozojë masa për mbrojtjen dhe adaptimin nga ndryshimet klimatike sidomos për sistemin ujor.

Projekte në këtë drejtim janë pyllëzimet dhe veprat inxhinierike si: hidrovore, pompa dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse dhe kulluese;

- Përforcimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;

- Studim dhe projektim për realizimin e veprave që mbrojnë brigjet ujore nga erozioni.




- Zona e vërshimit të ujërave dhe përmbytjeve
- Vija Blu përgjatë turpave ujorë
- Vija Blu përgjatë bregdetit
- Masa mbrojtëse ndaj vërshimit të ujërave si pyllëzimi, krijimi i ligatinave, vepra inxhinierike për mbrojtjen e brigjeve.
- Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur. (Secili qark të ketë minimalisht një impiant.)

### LEGJENDA

- Brezi bregdetar
- Vija turistike sipas PINS Bregdeti
- Vija Blu për mbrojtjen e korridoreve ujore sipas PPK
- Zonat e vërshimit të ujit dhe përmbytjeve
- Lumenj të pastër
- Lumenj të ndotur
- Masa për mbrojtjen nga vërshimi i ujërave
- Zona industriale shumë të dëmshme
- Impiante të trajtimit të ujërave të ndotur
- Urbanizimi
- Ujëra sipërfaqësore, lumenj, liqene, rezervuare, etj.
- Ndotje kimike
- Ndotje urbane
- Vendet e depozitimit të mbeturinave
- Vendet e ndotjes urbane dhe industriale
- Erozioni bregdetar
- Metropol
- Qendër primare
- Qendër sekondare
- Qendër terciare
- Qender lokale e specializuar